

KAPITULLI I APC-SË MBI TË DREJTAT E INTERNETIT

Internet për Drejtësi Shoqërore dhe Zhvillim të Qëndrueshëm

TEMA 1: QASJE NË INTERNET PËR TË GJITHË

1.1 Ndikimi i qasjes në zhvillim dhe drejtësi shoqërore

Qasja e mundshme, e shpejtë dhe e lehtë në internet mund të ndihmojë në krijimin e shoqërive më të barabarta. Ajo mund të fuqizojë shërbimet arsimore dhe shëndetësore, bizneset lokale, pjesëmarrjen publike, qasjen në informata, qeverisjen e mirë dhe çrrënjosjen e varfërisë. Por nuk duhet të supozojmë që të gjitha zbulimet teknologjike janë automatikisht mirëbërëse. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC-të), qeveritë dhe agjencitë rregullatore duhet janë të vetëdijshme mbi potencialin e internetit për të fuqizuar pabarazinë ekzistuese.

1.2 E drejta për qasje në infrastrukturë pa marrë parasysh ku jetoni

Interneti shërben si një infrastrukturë publike globale. Kjo infrastrukturë duhet të shpërndahet gjerësisht dhe të mbështesë bandwidth të mjaftueshëm, i cili do të mundësojë njerëzve kudo të përfitojnë nga potenciali për të ngritur zërat e tyre, Përmirësimin e jetëve dhe shprehjen e krijimtarisë së tyre. Njerëzit kanë të drejtë në një shtyllë kombëtare interneti që është e lidhur me rrjetin ndërkombëtar.

1.3 E drejta për aftësi

Njohuria dhe aftësia u mundësojnë njerëzve të përdorin dhe formësojnë internetin për të plotësuar nevojat e tyre. Qeveritë lokale dhe ndërkombëtare, organizatat ndërkombëtare dhe të komunitetit si dhe entitetet e sektorit privat duhet të mbështesin dhe promovojnë mundësitë pa pagesë ose të lira, metodologjitë dhe materialet që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e internetit për zhvillimin shoqëror.



NENI 26, DEKLARATA UNIVERSALE E DREJTAVE TË NJERIUT (DUDNJ): ARSIMI DUHET TË DREJTOHET NGA ZHVILLIMI I PLOTË I PERSONALITETIT DHE NGA FORCIMI I RESPEKTIMIT TË DREJTAVETË NJERIUT DHE LIRIVETHEMELORE

1.4 E drejta për pamje, përmbajtje dhe aplikacione të qasshme për të gjithë ("dizajn gjithëpërfshirës")

Pamjet, përmbajtja dhe aplikacionet duhet të dizajnohen në atë mënyrë që të sigurojnë qasshmëri për të gjithë, përfshirë edhe njerëzit me paaftësi fizike, ndijore apo njohëse, njerëz që nuk dinë shkrim-lëxim dhe të cilët flasin gjuhët e pakicave. Parimi i dizajnit gjithëpërfshirës dhe përdorimi i teknologjive ndihmëse duhet të promovohet që tu lejojë personave me paaftësi të përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe në kushte të barabarta me njerëz të cilat nuk kanë paaftësi.

1.5 E drejta për qasje të barabarta për burrat dhe gratë

Në shumë vende gratë dhe burrat nuk kanë qasje të barabartë për të mësuar, definuar, qasur dhe formësuar internetin. Përpjekjet për të ngritur qasjen duhet të njohin dhe të korrigjojnë pabarazitë ekzistuese gjinore. Duhet të ketë pjesëmarrje të plotë të grave në të gjitha fushat e zhvillimit të internetit për të siguruar barazi gjinore.

1.6 E drejta për qasje që mund të përballohet

Krijuesit e politikave dhe rregullatorët duhet të sigurojnë që të gjithë qytetarët të kanë qasje të përballueshme në internet. Zhvillimi i infrastrukturës telekomunikuese, dhe vendosja e rregullave, çmimeve, taksave dhe tarifave, duhet tu lejojë qasje të gjitha grupeve me të ardhura.

1.7 E drejta për qasje në vend të punës

Për shumë njerëz, vendi i punës është qasja fillestare apo edhe e vetme për qasje në internet. Punëtorët dhe punëdhënësit duhet tu mundësojnë qasjen e internetit në vend të punës, përfshirë edhe për qëllimet e programeve të edukimit të punëtorit dhe të mbrojtjes së drejtat e punëtorëve.

1.8 E drejta në qasje publike

Shumë njerëz kurrë nuk do ta kanë fatin në qasjen private në kompjuterë apo në internet. Pika të qasjes publike siç janë tele-qendrat, bibliotekat, qendrat e komunitetit, klinikat dhe shkollat duhet të janë në dispozicion që të gjithë njerëzit të kanë qasje në to afër vendeve ku jetojnë apo punojnë. Kjo është posaçërisht e rëndësishme për të rinjtë në vendet ku qasja ende nuk është në dispozicion apo e përballueshme.

1.9 E drejta për qasje dhe krijim të përmbajtjes që është e llojllojshme kulturore dhe gjuhësore

Ueb faqet, mekanizmat online dhe softuerët dominohen nga përdorimi i shkrimit latin. Kjo ndikon zhvillimin e përmbajtjes lokale në gjuhët jo-latine dhe pengon mundësinë e shkëmbimit të përmbajtjes ndërkulturore. Zhvillimet teknike duhet të inkurajojnë llojllojshmëri gjuhësore në internet dhe thjeshtësim të shkëmbimit të informacionit përtej barrierave gjuhësore.

TEMA 2: LIRIA E SHPREHJES DHE BASHKIMI

2.1 E drejta për lirinë e shprehjes

Liria e shprehjes duhet të mbrohet nga shkelja e qeverisë dhe akterët jo-shtetëror. Interneti është një medium për shkëmbim publik apo privat të pikëpamjeve dhe informatave përtej një vargu të kufijve. Individët duhet të janë në gjendje të shprehin opinione dhe ide, dhe të ndajnë informata në mënyrë të lirshme kur përdorin internetin.



NENI 18, DUDNJ: GJITHKUSH KA TË DREJTËN E LIRISË SË MENDIMIT, NDËRGJEGJES DHE BESIMIT



NENI 19, DUDNJ: GJITHKUSH KA TË DREJTËN E LIRISË SË MENDIMIT DHE TË SHPREHJES; KJO E DREJTË PËRFSHIN LIRINË E MENDIMIT PA NDËRRHYJE, SI DHE LIRINË E KËRKIMIT, MARRJES DHE NJOFTIMIT TË INFORMACIONIT DHE IDEVE ME ÇFARËDO MJETI QOFTË, PA MARRË PARASYSH KUFIJTË

2.2 E drejta për liri nga censura

Interneti duhet të mbrohet nga të gjitha tentimet për të heshtur zërat kritik dhe censurimi shoqëror si dhe përmbajtjes politike ose debatit.

2.3 E drejta për tu angazhuar në protestë online

Organizatat, komunitetet dhe individët duhet të janë të lirë për të përdorur internetin për të organizuar apo angazhuar në protestë.



NENI 20, DUDNJ: GJITHKUSH KA TË DREJTËN E LIRISË SË MBLEDHJES DHE BASHKIMIT PAQËSOR

TEMA 3: QASJA NË NJOHURI



NENI 27, DUDNJ: GJITHKUSH KA TË DREJTËN TË MARRË PJESË LIRISHT NË JETËN KULTURORE TË BASHKËSISË, TË GËZOJË ARTET DHE TË PËRFITOJË NGA PËRPARIMI SHKENCOR DHE DOBITË ETJ

3.1 E drejta për qasje në njohuri

Qasje e gjithanshme në njohuri dhe një njohuri e shëndoshë e përbashkët formon bazën për zhvillim të që qëndrueshëm njerëzor. Për shkak që interneti mundëson ndarjen e njohurisë dhe krijimin bashkëpunues të njohurisë në një shkallë të pashembullt, duhet të jetë fokus për zhvillimin e komunitetit.

3.2 E drejta për liri të informacionit

Qeveria kombëtare dhe lokale, dhe organizatat ndërkombëtare të mbështetura publikisht, duhet të sigurojnë transparencë dhe përgjegjësi duke vendosur informata relevante publike që ato prodhojnë dhe menaxhojnë në domenin publik. Ato duhet të pajtojnë dhe këto informata të shpërndahen online duke përdorur kompjuterë me të vjetër dhe lidhje të ngadalshme interneti.

3.3 E drejta për qasje në informata të fondeve publike

Të gjitha informatat, përfshirë edhe ato shkencore dhe hulumtime shoqërore, që krijohen me matetjet, etj. duhet të jenë në dispozicion të publikut dhe të jenë të lirë në dispozicion për të gjithë.

TEMA 4: MËSIMI I NDARË DHE KRIJIMI – SOFTUERI I LIRË DHE I HAPUR DHE ZHVILLIMI I TEKNOLOGJISË



NENI 27, DUDNJ:

GJITHKUSH KA TË DREJTË TË MARRË PJESË LIRISHT NË JETËN KULTURORE TË BASHKËSISË, TË GËZUJË ARTET DHE TË PËRFITOJË NGA PËRPARIMI SHKENCOR DHE DOBITË ETU

4.1 E drejta për të ndarë

Interneti ofron mundësi të jashtëzakonshme për ndarjen e informatave dhe njohurisë, dhe për format e reja të krijimit të përmbajtjes, mekanizmave dhe aplikacioneve. Ofruesit e mekanizmave, shërbimeve të internetit dhe përmbajtjes, nuk duhet të ndalojnë njerëzit nga shfrytëzimi i internetit për mësim të ndarë dhe krijim të përmbajtjes. Mbrojtja e interesave të krijuesit duhet të paraqitet në një mënyrë të përputhje me pjesëmarrjen e hapur dhe të lirë në rrjedhat shkencore dhe kulturore të njohurisë.

4.2 E drejta për softuer të lirë dhe me kod të hapur (FOSS)

Ne mbështesim përdorimin e FOSS-it. Puna me FOSS është fuqizuese, krijon aftësi, është më e qëndrueshme dhe inkurajon inovacion lokal. Ne inkurajojmë qeveritë që të krijojnë politika që inkurajojnë përdorimin e FOSS-it, e posaçërisht në sektorin publik.

4.3 E drejta për standardet e hapura teknologjike

Standardet teknike të përdorura në internet gjithmonë duhet të janë të hapura për të mundësuar ndërveprim dhe inovacion. Zhvillimi i teknologjive të reja duhet t'i plotësojë nevojat e të gjitha seksioneve të shoqërisë, posaçërisht atyre që përballen me kufizime kur janë online (siç janë komunitetet të cilat përdorin shkrimin jo-latin apo personat me paaftësi, kompjuterët e vjetër që kanë mungesë të qasjes me shpejtësi të lartë).

4.4 E drejta për të përfituar nga konvergjenca dhe përmbajtja multimediale
Interneti është një platformë multimediale. Qasjet dhe rregullat duhet të ndërtohen në potencialin e saj për të bërë krijimin e llojllojshëm dhe pronësinë e përmbajtjes online në formate të shumta si p.sh. radio dhe televizion të pronësuar dhe të udhëhequr nga komuniteti.

TEMA 5: INTIMITETI, MBIKËQYRJA DHE ENKRIPTIMI

5.1 E drejta për mbrojtjen e të dhënave

Organizatave publike apo private që kërkojnë informata personale nga individët duhet të marrin vetëm informatat minimale të duhura dhe për periudha sa më shkurtra që është e mundur. Ata duhet vetëm të përpunojnë të dhënat për qëllimet minimale të theksuara. Mbledhja, përdorimi, zbulimi dhe ruajtja e këtyre informatave duhet të pajtohet me një rregullore transparente të intimitetit e cila u mundëson njerëzve që të marrin vesh çfarë është marrë nga ata dhe të korrigjojnë informatat e pasakta. Të dhënat e mbledhura duhet të mbrohen nga zbulimi i paautorizuar dhe gabimet e sigurimit duhet të zgjidhen pa ndonjë vonesë.

Të dhënat duhet të shlyhen kur nuk nevojiten për qëllimin për të cilin janë grumbulluar. Publiku duhet të paralajmërohet për potencialin e keqpërdorimit të dhënave të ofruara. Organizatat kanë për detyrë të njoftojnë njerëzit kur informatat e tyre janë keqpërdorur, humbur, apo vjedhur.



NENI 12, DUDNJ:

ASNJERI NUK DUHET T'I NËNSHTROHET NDRËHYRJES ARBITRARE NË JETËN, FAMILJEN, BANESËN OSE KORRESPONDECËN VETJAKE, SI DHE SULMEVE KUNDËR NDERIT DHE PRESTIGJIT PERSONAL

5.2 E drejta për liri nga mbikëqyrja

Njerëzit duhet të janë në gjendje të komunikojnë lirshëm nga kërcënimi për mbikëqyrje dhe kapja.

5.3 E drejta për përdorimin e enkriptimit

Njerëzit që komunikojnë në internet duhet të kanë të drejtën për të përdorur mekanizma të cilat kodojnë porositë për të siguruar komunikim të sigurt, privat dhe anonim.

TEMA 6: QEVERISJA E INTERNETIT

6.1 E drejta për mbikëqyrje shumëpalëshe dhe demokratike të internetit

Qeverisja e internetit duhet të jetë shumëpalëshe dhe demokratike, me përfshirjen e plotë të qeverive, sektorit privat, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare. Asnjë Qeveri nuk duhet të ketë një rol të epërsisë në lidhje me qeverisjen ndërkombëtare të internetit.

6.2 E drejta për transparencë dhe qasshmëri

Të gjitha proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe zhvillimin e internetit duhet të janë të hapura dhe të qasshme në nivelet globale, rajonale dhe kombëtare.

6.3 E drejta për internet të decentralizuar, bashkëpunues dhe ndërveprues

Zhvillimi teknologjik dhe menaxhimi i burimeve bazë të internetit duhet të janë të decentralizuara dhe bashkëpunuese, dhe të ndihmojnë në sigurimin që rrjeti të jetë ndërveprues, funksional, stabil, i sigurt, efektiv dhe i matshëm në afat të gjatë.

6.4 E drejta për arkitekturë të hapur

Interneti si një 'rrjet i rrjeteve' përbëhet nga shumë rrjete të ndërlidhura, bazuar idenë e shtrirjes së arkitekturës së rrjetës së hapur, në të cilën çfarëdo lloj rrjete kudo mund të përfshihet dhe të bëhet e mundshme në publik. Arkitektura e hapur duhet të mbrohet.

6.5 E drejta për standarde të hapura

Shumica e protokolleve në bazën e internetit janë protokolle të bazuara në standarde të hapura që janë të efektshme, të besueshme dhe të hapurq për implementim global me disa përkuqizime licencimi apo edhe pa to. Specifikat e protokollit duhet të mbesin të mundura për këdo, pa ndonjë pagesë, gjë që në formë të konsiderueshme zvogëlon pengesat për tu futur dhe mundësuar ndërveprimin.

6.6 E drejta për neutralitet të internetit dhe parimi tejmbanë

Neutraliteti i internetit, kryesisht i ngarkuar me transportim të efektshëm të paketave, mundëson inteligjencën e tij që të mbes në masë të madhe në kompjuterë, aplikacione, serverë, celularë dhe pajisje tjera në *fundet* e rrjetave.

Kjo ka mundësuar zhvillimin e një sërë aktivitetesh të reja të internetit, industri dhe shërbime "në funde", dhe shndërron internetin në një mekanizëm të rëndësishëm në kontekst më të gjerë të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

Interneti nxjerr të shumtën e fuqisë së tij dhe fiton nga vlera e efektit të tij rrjetës. Sa më shumë njerëz që kanë qasje në internet, aq më e madhe është vlera e tij si një mjet për shkëmbim informacioni dhe komunikimi. Parimi tejmbanë dhe neutraliteti i rrjetës duhet të janë të mbrojtura nga përpjekjet për të krijuar një internet dy radhësh dhe kontrolli centralizuar.

6.7 E drejta për internet si një njësi e integruar

Ky ndërveprim qendror është pjesë e vlerës së internetit si një e mirë globale publike dhe nuk duhet të fragmentohet nga kërcënimet për krijimin e intraneteve kombëtare, përdorimit të filterëve të përmbajtjes, vëzhgimit të pajustifikuar, cenimit të intimitetit dhe frenimit të lirisë së shprehjes.

TEMA 7: DITURIA, MBROJTJA DHE REALIZIMI I TË DREJTAVE

7.1 E drejta për mbrojtjen e të drejtave, dituri dhe arsimim

Të drejtat e njerëzve si përdorues të internetit duhet të mbrohen nga deklaratat ndërkombëtare të drejtave të njeriut, ligji dhe praktikave të politikave. Organet udhëheqëse kombëtare, rajonale dhe globale duhet të bëjnë informacionin mbi të drejtat dhe procedurat që kanë të bëjnë me internet sa më të mundshme. Kjo përfshinë edukimin publik për të informuar njerëzit mbi të drejtat e tyre derisa përdorin internetin dhe mekanizmat për adresimin e shkeljes së drejtave.

7.2 E drejta për mbështetje kur të drejtat janë shkelur

Njerëzit kanë nevojë për tasje kur të drejtat në mekanizma efektiv dhe përgjegjës për të adresuar shkeljen e të drejtave. Kur të drejtat njerëzore dhe të internetit janë kërcënuar nga përmbajtjet në internet, apo nga ndonjë vëzhgim joligjor, kufizimet në liritë e shprehje, dhe të drejtat tjera, palët duhet të kenë qasje në mekanizma mbështetës për të dhënë veprat tjera, kundër shkeljeve të tillë.

Interneti mund të jetë vetëm një mekanizëm për të fuqizuar njerëzit e botës nëse të drejtat brenda këtij Kapitulli njihen, mbrohen dhe respektohen.



APC

ASSOCIATION
FOR PROGRESSIVE
COMMUNICATIONS

www.apc.org info@apc.org